



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 619/1 prot.

Tiranë, më 12.06.2023

### V E N D I M

#### Nr. 100, datë 12.06.2023

Mbështetur në ligjin nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 93 Regj., datë 23.05.2023, që i përket ankuesit z. T.S, kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës<sup>1</sup> dhe Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë<sup>2</sup>, me pretendimin diskriminimin për shkak të *etnisë, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, gjendjes familjare, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër*<sup>3</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të paraqitur, ankuesi është një ndër 70 familjet e pakicës kombëtare rome që kanë banuar në zonën e Selitës, në Tiranë. Banesa e tij dhe e 70 familjeve të tjera të pakicës kombëtare rome, janë prekur nga ndërtimi i Unazës së Madhe. Sipas ankuesit, ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit për të përfituar nga subvencionimi i qirasë sipas VKM-së nr. 44, datë 30.01.2019, u është kërkuar të plotësojnë një sërë dokumentesh, për çdo person madhor, anëtar të familjes. Ky dokumentacion mund të sigurohej nëpërmjet portalit *e-albania* dhe për këtë arsye anëtarët e këtyre familjeve janë vënë në vështirësi për shkak të: nivelit të ulët arsimor, mungesës së njohurive të IT, pamundësisë për të përdorur portalin *e-albania* dhe pamundësisë ekonomike për të kërkuar asistencën nga subjekte private me qëllim përdorimin e portalit.

Ankuesja thekson se përpos kësaj, i është kërkuar një vërtetim për çdo person madhor në familje, të lëshuar nga ASHK dhe ALUIZNI, me anë të të cilit provohet fakti që nuk disponojnë prona dhe nuk kanë në proces legalizimi një të tillë.

Nëpërmjet Qendrës T’Reja, ankuesi thekson se ka arritur të sigurojë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, por nuk ka arritur të gjenerojë vërtetimet e kërkuara nga ASHK dhe ALUIZNI.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin ASHK.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin ASHK Tiranë.

<sup>3</sup> Për shkak të mungesës së njohurive të IT

Në vijim, ankuesi dhe familjet e tjera të gjendura në të njëjtën situatë, përmes Qendrës T'Reja, i janë drejtuar me anë të një shkrese zyrtare ASHK-së, duke kërkuar t'i asistojë për gjenerimin e dokumentacionit të sipërcituar, por janë informuar se duhet t'i drejtohen një noteri për të kryer këto veprime dhe për të përfunduar procesin e aplikimit. Ndërkohë, sipas ankuesit, ajo është informuar se një zyrë noteriale për të dhënë asistencën për sigurimin e dokumentacionit të kërkuar, ka një kosto prej 3000-3500 lekë, e cila është e papërballueshme nga këto familje.

Veç dokumentacionit të ASHK-së, kërkohet vërtetimi nga ALUIZNI për personat madhor të familjes, me anë të të cilit të vërtetohet fakti që nuk kanë në proces legalizimi një ndërtim informal. Për këtë, ankuesi dhe familjet të cilat ndodhen në të njëjtat kushte me të, i janë drejtuar ALUIZNI-t dhe i kanë kërkuar ndihmë për të përshpejtuar procesin për të marrë vërtetimin e sipërcituar, por janë informuar se sistemi i tyre ka një problem teknik dhe procesi për të gjeneruar këtë dokument kërkon më shumë kohë nga ajo e parashikuar në legjislacionin përkatës. Në këto kushte, përmes Qendrës T'Reja, i janë drejtuar me ankesë portalit të Bashkëqeverisjes, por nuk kanë marrë një zgjidhje.

Përsa më lart, ankuesi thekson se është në pamundësi ekonomike për të përballuar qiranë dhe qiradhënësi i banesës ku ai jeton aktualisht, ka kërkuar shlyerjen e detyrimit mujor të qirasë. Në këto kushte, sipas tij, për shkak të mungesës së dokumentacionit të sipërcituar, rrezikon të mbetet në rrugë.

Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese nga ana e ASHK-së dhe të rekomandohet marrja e masave nga institucionet përgjegjëse në mënyrë që të ketë mundësi të përfitojë bonusin e qirasë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, përcaktohet se: "*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*".

Neni 7/1 i LMD-së<sup>4</sup>, parashikon se: "*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj*

<sup>4</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

*një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b<sup>5</sup>, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në vijim, ankuesi me shkresën datë 06.06.2023, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, pasi çështja e përfitimit të bonusit të qirasë ka gjetur zgjidhje pas lehtësimit të disa procedurave nga ana e Bashkisë Tiranë.

Sakaq, Komisioneri vlerëson shumë pozitivisht veprimet e ndërmarra dhe reagimin e menjëhershëm të Bashkisë Tiranë në lehtësimin e procedurave të përfitimit të bonusit të qirasë, për ankuesin dhe familjet e tjera të gjendura në të njëjtën situatë. Në këtë situatë, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se: *“Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën*

---

<sup>5</sup> Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

*administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga z. T.S, i cili me anë të kërkesës, datë 06.06.2023 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 93, datë 23.05.2023, të paraqitur nga z. T.S, kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Etnia, gjendja ekonomike, gjendja shoqërore, gjendja familjare, përkatësia në një grup të veçantë, çdo shkak tjetër.  
Fusha: Shërbime  
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti